



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
INSPEKTORATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT

LISTË-VERIFIKIMI PËR MBROJTJEN, MBIKËQYRJEN DHE KONTROLLIN E
ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT NË FUQI, PËR MBROJTJEN E PYJEVE

Nr.

Datë:

Qarku:

Subjekt i inspektuar për herë të:

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË SUBJEKTIT

1.	Emri i Subjektit	
2.	Data e Fillimit të aktivitetit	
3.	Lloji i aktivitetit ekonomik	
4.	Adresa - Qendër (Rrugë, Njësi, Telefon)	
5.	Adresa të tjera - Filiale (Rrugë, Njësi, Telefon)	
6.	Përfaqësuesi i subjektit (emër, atësia, mbiemri)	
7.	NUIS - QKR (Nr Unik i Identifikimit)	
8.	Tipi i Pronësisë	Tipi i Subjektit

LISTË-VERIFIKIMI PËR MBROJTJEN, MBIKËQYRJEN DHE KONTROLLIN E ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT
NË FUQI, PËR MBROJTJEN E PYJEVE

Objekti: Inspektim në Fondin Pyjor Kombëtar (Bashkiak, Shtetëror, Privat).

Nr	Baza ligjore	Kërkesa	Vlerësimi (Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
1	Germa a, Pika 2, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 "Për Pyjet".	A ka nxjerrje dhe grumbullim të prodhimeve drusore dhe jodrusore nga individë të pa formalizuar dhe pa lejen përkatëse?		
2	Germa b, Pika 2, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 "Për Pyjet".	A ka prerje pa damkë të drurëve dhe prerja pa leje e pyjeve, drurëve të veçuar dhe e shkurreve, filizërisë dhe e fidanëve në fidanishte, kur pasojat materiale janë të lehta?		

Nr .	Baza ligjore	Kërkesa	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
3	Germa c, Pika 2, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka mbledhje të prodhimeve jodrusore nga pylli jashtë periudhës teknike të vjeljes, si dhe nxjerrja e rrënjëve të drurëve pyjorë gjatë periudhës së vegetacionit?		
4	Germa ç, Pika 2, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka kullotje të bagëtime në fondin pyjor kombëtar të përfshirë në zonat e mbrojtura, në pyllëzimet e reja dhe në sipërfaqet me pyje të ulëta të ricunguara, në grumbujt pyjorë, që kanë arritur moshën e pjekurisë, në të cilët pritet që të arrihet ripërtëritja natyrale, në pyjet e shfrytëzuara ose në shfrytëzim e sipër deri sa të jetë bërë ripërtëritja natyrale e tyre, në pyjet e reja, në filizëri, në fidanishte, në ngastrat gjenetike e eksperimentale, në sipërfaqet ku kryhen punime përmirësuese dhe në pyjet mbrojtës?		
5	Germa d, Pika 2, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka krasitje për gjethe, kositje dhe grumbullimin e barit në fondin pyjor kombëtar pa lejen përkatëse?		
6	Germa dh, Pika 2, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka parkim të automjeteve, vendosje të rulotëve në pyjet me funksion mbrojtës të veçantë, në parqet kombëtare, në rezervatet e mbarështimit të florës e të faunës së egër, në fidanishtet pyjore ose në vendet e tjera të fondit pyjor kombëtar, me rëndësi të veçantë, pa lejen përkatëse?		
7	Germa e, Pika 2, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka nxjerrje të gurëve, plisave, rrënjëve, cungjeve, marrja e dheut, rërës dhe zhavorrit, kur pasojat material janë të lehta, pa lejen përkatëse?		
8	Germa ë, Pika 2, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka mos ruajtje të materialit drusor dhe e çdo prodhimi tjetër, me origjinë pyjore, të sekuestruar, i cili ndodhet në qendrat e përpunimit apo në sheshet e depozitimit e të tregtimit, nga subjektet të cilave u është sekuestruar, deri në shitjen e tyre?		

Nr .	Baza ligjore	Kërkesa	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
9	Germa a , Pika 3, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka ndërhyrje në pyllëzime dhe përmirësimi të bimësisë së tokave pyjore pa lejen përkatëse dhe në kundërshtim me rregullat për pyllëzimet, përfshirë pyllëzimin me farë në terrenet e zhveshura, si dhe përdorimi i plehrave kimike apo pesticideve pa lejen përkatëse dhe në kundërshtim me rregullat?		
10	Germa b , Pika 3, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka grumbullim, shpërndarje ose mbjellje të farave, kalemave, shpatullave të fidanëve pyjorë të drurëve e shkurreve pyjore pa lejen e agjencisë shtetërore përgjegjëse për pyjet, mbjellje e farave dhe e materialit tjetër vegjetativ pyjor, të pa pajisur me certifikatën përkatëse, si dhe shitje apo shpërndarje nga fidanishtet, që merren me aktivitetin prodhues të materialit vegjetativ mbjellës dhe farërave, të pashoqëruar me certifikatën e origjinës dhe atë fitosanitare?		
11	Germa c , Pika 3, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka prishje, fshirje ose dëmtim të shenjave kufidëftuese, gjeodezike e topografike i tabelave paralajmëruese apo treguese, të vendosura në fondin pyjor kombëtar?		
12	Germa ç , Pika 3, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka prerja pa leje apo dëmtimi i pyjeve, në pronësi private, nga pronarët apo nga subjektet, të cilave u janë dhënë në përdorim ose me qira, kur pasojat material janë të lehta?		
13	Germa a , Pika 4, Neni 36 Ligji Nr. Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka ngritje strukturash, punime, zhvillime të ndryshme dhe kryerje të veprimtarive në fondin pyjor kombëtar pa lejen përkatëse?		
14	Germa b , Pika 4, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka ndezje të zjarreve jashtë vendeve të caktuara apo në fondin pyjor kombëtar, publik dhe privat, në tokat e tjera në afërsi të tyre, si dhe veprime të tjera që përbëjnë burim ose shkak për përhapje të pakontrolluar të tij?		
15	Germa c , Pika 4, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka prishje të shenjës së damkës në dru apo përdorim të çekiç damkës nga persona të pa autorizuar, nga një zone pyjore në tjetrën?		

Nr .	Baza ligjore	Kërkesa	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
16	Germa ç , Pika 4, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka ndryshim të zërit kadastral në kundërshtim me procedurat ligjore në fuqi dhe mos raportim të ndryshimeve përkatëse në fondin pyjor kombëtar dhe në tokën pyjore, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e njësisë së qeverisjes vendore dhe pronarin privat?		
17	Germa d , Pika 4, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka shndërrim të pyjeve të larta në cungishte, prerje rrah e pyjeve të larta (me përjashtim të ndërhyrjeve të nevojshme për mbrojtjen fitosanitare ose për arsye të tjera me interes publik),si dhe shfrytëzim të pyjeve cungishte dhe prerja rrah në periudhën e vegjetacionit, si dhe kur nuk sigurohet mbrojtja hidrogeologjike e territorit, ruajtja e burimeve ujore, mbrojtja e peizazhit dhe mjedisit, turizmi dhe rekreacioni?		
18	Germa dh , Pika 4, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka prerje rrah në pyjet me funksion mbrojtës, si dhe prerje te pyjeve në kufijtë e sipërm të vegjetacionit pyjor, mbi dhe nën rrugët kombëtare deri 150 metër linear, përreth qendrave të banuara dhe objekteve të rëndësishme, përgjatë rrjedhave ujore?		
19	Germa a , Pika 5, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka transferim të të drejtave të siguruara nga kontrata e trajtimit, shfrytëzimit dhe përdorimit në fondin pyjor kombëtar?		
20	Germa b , Pika 5, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020, “ Për Pyjet”.	A ka tregtim të materialit drusor dhe të prodhimeve të tjera të pyllit, të infektuara nga sëmundjet, barërat e këqija e parazitare ose të prekura nga insektet?		
21	Germa c , Pika 5, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka mbledhje të prodhimeve jo drusore nga pylli, me mënyra që sjellin degradimin, kërcënimin, rrallimin, zhdukjen apo dobësimin e funksioneve të tyre?		
22	Germa ç , Pika 5, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka kryerje të veprimtarive pa lejen përkatëse kur kryhet në fondin pyjor kombëtar, të deklaruar me funksion mbrojtës e të veçantë (si ngritja e ndërtimeve të thjeshta, gardhimeve, kampingjeve, ndërhyrjet me punime në dunat bregdetare, pjesë e fondit pyjor kombëtar etj.)?		

Nr .	Baza ligjore	Kërkesa	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
23	Germa d , Pika 5, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka përdorim të paligjshëm të fondit pyjor kombëtar dhe I tokës pyjore?		
24	Germa a , Pika 6, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka eksport të lëndës së drurit të papërpunuar, lëndës së ndërtimit, druve të zjarrit dhe asortimenteve që rrjedhin nga tjetërsimi i tyre, si edhe qymyrit të drurit, apo të tjera produkte, gjithmonë kur këto ndalohen specifikisht të eksportohen me ligj apo vendim të Këshillit të Ministrave?		
25	Germa b , Pika 6, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka ndërtim të objekteve dhe zhvillim të veprimtarive, që shkaktojnë degradimin dhe gërryerjen e tokës(si ndërtimi i furrave të gëlqeres dhe i kaminave të qymyrit të drurit, dëmtimi i infrastrukturës pyjore, si rrugë dhe vepra ujore në fondin pyjor kombëtar)?		
26	Germa c , Pika 6, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka mos ripyllëzim të sipërfaqeve ose i brezave pyjor pas prerjeve rrah të llojeve që nuk ripërtërihen në rrugë natyrore, si dhe mospyllëzim/ripyllëzim nga ana e personave fizikë/juridikë për sipërfaqe që hiqen nga fondi pyjor kombëtar?		
27	Germa ç , Pika 6, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka hedhje të mbetjeve brenda sipërfaqes së fondit pyjor kombëtar dhe jashtë vendeve të caktuara, kur pasojat materiale janë të lehta?		
28	Germa a , Pika 7, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka transport me automjete apo mjete të tjera I materialit drusor nga pylli dhe prej shesheve të depozitimit për në qendrat e përpunimit e të shitjes, si dhe i produkteve jo drusore pyjore drejt qendrave të grumbullimit, i pashoqëruar me dokumentacionin që provon origjinën e tij?		
29	Germa b , Pika 7, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka mosrealizim të masave apo punimeve të parashikuara në projekte në mjedisin pyjor, si dhe mos pastrimi i parcelës së shfrytëzuar?		
30	Germa a , Pika 8, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka shkarkime të kimikateve, të ujërave të ndotura industrial në fondin pyjor kombëtar?		
31	Germa b , Pika 8, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka gërmime për karriera të çdo lloji që përdorin lëndë plasëse pa lejen përkatëse?		

Nr .	Baza ligjore	Kërkesa	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
32	Germa c , Pika 8, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka djege të sipërfaqeve të fondit pyjor kombëtar, me qëllim ndryshimin e destinacionit të tyre, ndryshimin e destinacionit të sipërfaqeve të djegura në fondin pyjor kombëtar, si dhe kur cenon ruajtjen e biodiversitetit, stabilitetin e terrenit, regjimin e ujit, mbrojtjen nga rënia e gurëve dhe ortekëve, ruajtjen e peizazhit, si dhe rolin e pyjeve për mbrojtjen nga era?		
33	Germa a , Pika 9, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka prerje pa damkë të drurëve dhe prerja pa leje e pyjeve, drurëve të veçuar dhe e shkurreve, filizërisë dhe e fidanëve në fidanishte, me pasoja të rënda?		
34	Germa b , Pika 9, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka nxjerrje të gurëve, plisave, rrënjëve, cungjeve, marrja e dheut, rërës dhe zhavorrit, me pasoja të rënda dhe pa lejen përkatëse?		
35	Germa c , Pika 9, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka hedhje të mbetjeve brenda sipërfaqes së fondit pyjor kombëtar dhe jashtë vendeve të caktuara, me pasoja të rënda?		
36	Pika 11, Neni 36 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka veprime apo mosveprime për të zbatuar përgjegjësitë ligjore, të institucione, strukturave apo persona përgjegjës për ruajtjen e fondin pyjor kombëtar?		
37	Germa a, Pika 1, Neni 67 Ligji Nr. 81/2017, “Për Zonat e Mbrojtura”	A ka ndotje dhe dëmtim të zonës së mbrojtur nga shkarkimet mbi normë të veprimtarive që zhvillohen jashtë zonës, por në afërsi të saj?		
38	Germa b, Pika 1, Neni 67 Ligji Nr. 81/2017, “Për Zonat e Mbrojtura”	A ka zhvillim të zonës të veprimtarive që nuk janë pajisur me leje mjedisi?		
39	Germa c, Pika 1, Neni 67 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka mos përmbushje dhe mos respektim të kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit, sipas parashikimeve të këtij ligji?		
40	Germa ç, Pika 1, Neni 67 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka dëmtim të zonave të mbrojtura nga pronarët e pasurive private që ndodhen brenda zone?		
41	Germa d, Pika 1, Neni 67 Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet”.	A ka dëmtim të zonave të mbrojtura nga përdoruesit e zonës?		

Nr .	Baza ligjore	Kërkesa	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
42	Pika 1, Neni 6 Ligj Nr.5/2016 “Për shpalljen e Moratoriumit në pyje ne Republikën e Shqipërisë”.	A ka ushtrim të veprimtarisë së shfrytëzimit të lëndës drusore në fondin pyjor, publik/privat, tregtim të produkteve të tij, eksport të lëndës së drurit të papërpunuar, Lëndës së ndërtimit, drurëve të zjarrit, si dhe qymyrit të drurit?		

INSPEKTORËT